



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2023

Procesverbal

Nr 9, datë 21.07.2023


I mbledhjes së këshillit të bashkisë, e cila zhvillohet në sallën e mbledhjeve në Pallatin e Kulturës “Labëria”(Ora 10⁰⁰)

Marrin pjesë :

- | | |
|----------------------|----------------------|
| 1.Simo Petromilo | 25.Simbol Pazaj |
| 2.Rajmonda Zoto | 26.Arsen Belaj |
| 3.Besmir Brahimi | 27.Ledja Shollaj |
| 4.Gjergji Nika | 28.Vjola Xhafaj |
| 5.Edlira Kapllanaj | 29.Jerina Dervishaj |
| 6.Eglantina Aliaj | 30.Shkëlqim Leskaj |
| 7.Marsela Dashi | 31.Elca Bezhani |
| 8.Mujo Shakaj | 32.Grigor Dede |
| 9.Novrus Rrokaj | 33.Atird Hoxha |
| 10.Edison Kapaj | 34.Erëmal Arapi |
| 11.Liljana Breshani | 35.Geron Gunbardhi |
| 12.Evis Allushi | 36.Klodian Xhyheri |
| 13.Myzafer Elezi | 37.Alta Haluci |
| 14.Brikena Sika | 38.Aurora Qarri |
| 15.Liri Dëma | 39.Anxhela Shenaj |
| 16.Dikens Bushaj | 40.Lorel Canaj |
| 17.Eneida Vera | 41.Brikena Puka |
| 18.Ardian Musta | 42.Elpiniqui Mërkuri |
| 19.Endri Hyseni | 43.Ervis Moçka |
| 20.Englantina Imeraj | 44.Bujar Osmanaj |
| 21.Frosina Qyrdeti | 45.Roland Strakosha |
| 22.Illir Aliaj | 46.Eda Begaj |
| 23.Briseida Çakërri | 47.Arjan Isufi |
| 24.Anisa Ceno | |

Mungojnë :

- 1.Vullnet Bilbilaj
- 2.Sokol Kushta
- 3.Gëzim Çapoj
- 4.Refie Laze.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2023

Procesverbal
Nr 9/1, datë 21.07.2023

Znj.Elpinqi Mërkuri/ Kryetare e këshillit bashkiak – I nderuar Kryetar i bashkisë!

Të nderuar këshilltarë , ju uroj mirseardhjen. Si parlamenti i Vlorës, do ti përkushtohemi pa dallime partiake çështjeve dhe shqetësimeve të qytetarëve të Vlorës.

Para se të miratojmë rendin e ditës, do tju njoh me shprehjen e ligjshmërisë , ardhur nga institucioni i prefektit të qarkut, Vlorë, ku vendimet e këshillit bashkiak Nr 49 ÷52, janë shprehur të ligjshëm.(Lexon)

Vijojmë me miratimin e rendit të ditës. Ka pyetje ?

Z.Atird Hoxha - Për procedurë..Të paraqes një propozim të një grupi prej 7 këshilltarësh... Ju kemi dërguar një propozim për shfuqizimin e zgjedhjes së zëvendëskryetarit të këshillit të bashkisë, zotit Myzafer Elezi.

Bazuar në rregullore, në nenin 15, pika 15 .., ligjin për vetqeverisjen vendore , i cili thotë.....lexon, Neni 105propozimi kur nuk merret nga kryetari i bashkisë.., nga kryetare e këshillit i kalon kryetarit të bashkisë....Sqarimet e kryetarit të bashkisë i kalojnë mbledhjes së këshillit....

Ku e gjeni të drejtën që, ju zonja kryetare , me një shkresë, bëni një arsyetim ligjor...me numër - protokolli.....,drejtuar ne këshilltarëve që kemi bërë propozimin.

Z.Ermal Dredha/Kryetari i bashkisë – Trego frymë bashkëpunimi dhe etikë. Është çështje e këshillit bashkiak dhe jo e kryetarit të bashkisë.

Z.Atird Hoxha – Hidhe në votim, ju drejtova juve zonja kryetare.

Z.Ermal Dredha – Është bërë një votim.

Z.Atird Hoxha – Propozimin me shkrim , je e detyruar t'ia paraqesësh këshillit.

Znj.Elpinqi Mërkuri – Vazhdoni procedurën në rrugë ligjore...Ju jap përgjigje...

Z.Atird Hoxha - Kam bërë një propozim. Ju më keni kthyer një përgjigje, në tejkalim të kompetencave...Neni 105, pika 4Bëni proçedurën .

Votoni kundër, si të doni, por bëni proçedurën.

Znj.Elpinqi Mërkuri – Sygjerimi Juaj ?


Z.Atird Hoxha – Të ndryshohet rendi i ditës, ose të bëhet projektvendim për këtë propozim dhe sillet në këshill për votim...Për proçedurë, meqenëse, jemi tek rendi i ditës.

Z.Ervis Moçka – Sinqerisht do të doja që kjo mbledhje e parë , mos të niste kështu. Të dëgjojmë njëri tjetrin dhe të respektohet etika dhe ligji dhe, çdo lloj kërkesë . Përsa i përket kërkesës së grupit, është një propozim...Ne nuk jemi në dijeni të kësaj shkrese. Dëgjuam vetëm nga këshilltari, por pa trajtuar , shqyrtuar ky material...Pra, mos të ndryshojë rendi i ditës, nuk dimë për çfarë bëhet fjalë dhe, mbledhjen e radhës të njihemi me materialin.

Znj.Elpinqi Mërkuri - Vazhdojmë me votimin e rendit të ditës. Dhe në mbledhje tjetër shqyrtojmë propozimin tuaj dhe do e kalojmë.

Votohet rendi i ditës.

Miratohet me shumicë votash.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2023

Procesverbal

Nr 9/2, datë 21.07.2023

Znj.Elpinqi Mërkuri – Fillojmë me rendin e ditës. Pika e parë e rendit të ditës, “Për Konstituimin e Konferencës së kryetarëve të grupeve”.

Grupi i Partisë Socialiste ka dorëzuar dhe zoti Ervis Moçka , është kryetari i grupit.

Z.Atird Hoxha – Ka dy muaj kohë pas konstituimit të këshillit... Grupi ynë është i përbërë nga 9 anëtarë. Bashkë Fitojmë , propozojmë z.Klodian Xhyheri kryetar grupi. Edhe për komisionet , të tërhiqemi ti sjellim me shkrim.

Z.Gjergji Nika – Përfaqësohet nga Gjergji Nika ,Partia Demokratike . Komisionet i kemi nisur me shkrim.

Znj.Elpinqi Mërkuri - Pra, nga ;

- 1.Partia Socialiste , zoti Ervis Moçka
- 2.Bashkë Fitojmë, zoti Klodian Xhyheri
- 3.Partia Demokratike , zoti Gjergji Nika .

Z.Atird Hoxha - Meqenëse , grupet u përcaktuan , do të kërkoja dhe grupimin në sallë...

Znj.Elpinqi Mërkuri – Vazhdojmë me pikën e parë të rendit të ditës. Ju duhet akoma kohë të konsultoheni dhe vendosni ...Atëherë jeni gati? Keni ndonjë ndryshim ?

Z.Geron Gunbardhi – Faleminderit zonja kryetare! Zoti kryetar , ju uroj punë të mbarë . Jemi për një qëllim, për Vlorën...Pavarësisht votave do të kemi dhe debate për të mirën e Vlorës. Çdo gjë që është në kundërshtim ..., ne do të bëjmë punën.Ne si grup , përbërë nga Geron Bunbardhi-Partia Republikane; Znj.Eda Begaj - Partia Agrare Ambientaliste; dhe Z.Arsen Belaj – Aleanca Progresiste LZHK , propozojmë z.Geron Gunbardhi kryetar grupi, znj.Eda Begaj zv/kryetare.

Znj.Elpinqi Mërkuri – Bashkë Fitojmë, zv/kryetare znj.Anxhela Shenaj; Partia Socialiste z.Grigor Dede zv/kryetar dhe, Partia Demokratike znj.Eneida Vera zv/kryetare.

E kalojmë në votim, konferencën e kryetarëve të grupeve.

Votohet.

Pro - 46 vota.
Kundër - 0 vota.
Abstenim - 0 vota.

Miratohet



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2023

Procesverbal
Nr 9/3, datë 21.07.2023

Znj.Elpiniaqi Mërkuri – Kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës, në “Miratimin e Komisioneve të përhershëm të mbledhjeve të këshillit bashkiak”.

Z.Ervis Moçka - Janë 4 komisionet që i përkasin opozitës, komisioni i arsim kulturës, komisioni i peticioneve, komisioni i mbikqyrjes së procesverbaleve dhe komisioni i bujqësisë.

Znj.Elpiniaqi Mërkuri - E votojmë ?

Pro – 35 vota

Kundër - 0 vota

Abstenim – 0 vota.

Miratohet.

Znj.Elpiniaqi Mërkuri – Vazhdojmë me propozimet për komisionet..

Z.Ervis Moçka – Komisioni juridik, zoti Endri Hyseni...(lexon)

Komisioni i financës, zonja Elca Bezhani.....(lexon)

Komisioni i shërbimeve , zoti Ilir Aliaj ...(lexon)

Komisioni i urbanistikës, zoti Ardian Musta ...(lexon)

Komisioni i arsim kulturës, zoti Sokol Kushta..(lexon)

Lexon anëtarët për çdo komision. Gjithësej 12 komisione..

Z.Klodian Xhyheri -

Znj.Elpiniaqi Mërkuri – Propozoj të mblidhet kryesia, të hartojmë listën dhe më vonë e votojmë.

Z.Ermal Dredha – Për arsye pune, kërkoj mirëkuptimin tuaj, më duhet të largohem.

Znj.Elpiniaqi Mërkuri - Faleminderit zoti kryetar.

(Vjen zoti Arjan Isufi në pikën 2 të rendit të ditës.)

Vazhdojmë .

Z.Myzafer Elezi – Viojmë me emrat e anëtarëve të komisioneve.

Z.Atird Hoxha – Për proçedurë, zotëri ndërprite fjalën. Zonja kryetare është prezent.

Znj.Elpiniaqi Mërkuri – Lexon emrat e anëtarëve të

1-Komisionit Juridik

-7 anëtarëlexon emrat.... (Bashkëlidhur lista me emrat e propozuar për anëtarët e komisioneve)

Pro

Kryetar komisioni, zoti Endri Hyseni. Votohet

Kundër – 1 anëtar .

Pro shumicë votash.

2-Komisioni i financës , 7 anëtarëlexon emrat....

Pro – të gjithë

Kundër – 0 vota

Abstenim – 0 vota

Kryetare, zonja Elca Bezhani . Votohet

Kundër – 1 votë

Abstenim – 0

Pro...

Miratohet komisioni

3-Komisioni i mandateve dhe rregullores.

7 anëtarë....lexon emrat ...

Të gjithë pro.

Kryetar komisioni zonja Frosina Qyrdeti .

Votohet.

Kundër -1 votë

Abstenim – 1 votë

4-Komisioni i shërbimeve - 7 anëtarë, lexon emrat

Pro, të gjithë.

Kryetar komisioni zoti Ilir Aliaj. Votohet.

Kundër – 1 votë.

Miratohet.

5-Komisioni i arsimit kulturës - 7 anëtarë . Pro të gjithë

Znj Eneida Vera , kryetare komisioni. Votohet.

Të gjithë pro.

6-Komisioni për zhvillimin urbanistik - 7 anëtarë ..lexon emrat

Z.Klodian Xhyheri – Propozoj znj.Alta Haluci për kryetare komisioni...votohet, kundër – 1

Znj.Alta Haluci – Opozitën nuk e caktoni ju. Zoti Moçka është jurist.

Znj.Elpiniaqi Mërkuri – Vazhdojmë me komisionin e urbanistikës

7 anëtarë..lexon emrat

Kundër -1 anëtar

Kryetar komisioni z.Ardian Musta

Votohet.

Kundër – 1 votë

Abstenim – 0 vota

Z.Atird Hoxha – Ju zonja kryetare, drejtoni seancën. Si keni vendosur të gjitha komisionet ti.....

Si rregull këtu opozita është përcaktuar nga shkresa e ardhur nga KQZ-ja. Gjithë kjo opozitë, vetëm një anëtar, mund ti marrë të gjitha komisionet që i takojnë opozitës.

Znj.Elpiniqi Mërkuri – I kam të gjitha përgjigjet. Diskutoni votën time ?

7-Komisioni i shëndetësisë...7 anëtarë

Kryetare znj.Evis Allushi . Votohet

Abstenim – 1 votë

Kundër – 0 vota.

8-Komisioni i bujqësisë ...7 anëtarë

Pro

Kundër – 1 votë

Abstenim – 1 votë

Kryetar komisioni z.Besmir Brahimi.

Z.Arjan Isufi – Znj.Eda Begaj për kryetare komisioni...është votuar

Znj.Elpiniqi Mërkuri – 9-Komisioni i mbikqyrjes, kontrollit të proçesverbaleve..Votohet

Kundër – 2 vota

Abstenim – 0

Pro

Kryetare znj.Rajmonda Zoto ..

10-Komisioni i mardhënieve me jashtë. 7 anëtarë ..

Çfarë propozimi keni për kryetare ? Zonja Rajmonda ,nuk e pranon .

Z.Arjan Isufi – Propozoj për kryetare znj.Refie Laze.

Votohet.

Miratohet.

Znj.Elpiniqi Mërkuri – Vazhdojmë me komisionin për marrëdhëniet me jashtë .

7 anëtarë...rilexon emrat

Pro të gjithë.

Kryetare znj.Briseida Çakërri. Votohet

Kundër – 2 vota

Abstenim – 0

Miratohet.

11-Komisioni i barazisë gjinore. 7 anëtarë lexon emrat

Votohet. Pro të gjithë

Kundër – 0 vota.

Abstenim – 0 vota.

Znj.Frosina Qyrdeti , kryetare komisioni. Votohet

Znj.Anxhela Shenaj –Propozoj për kryetare komisioni zonjën Alta Haluci.

Znj.Elpiniaqi Mërkuri – E kemi votuar..

Z.Arjan Isufi – Do na pyesni edhe ne, e keni detyrim...A kemi propozuar ?

Znj.Elpiniaqi Mërkuri – I kemi kaluar 4 komisionet që ka marrë opozita për kryetar.

E hedhim në votim , për znj.Alta Haluci

Kundër -

Abstenim – shumicë votash.

Z.Ervis Moçka – U bë një votim që i takonin komisionet, opozitës . U votua...Ose të ishin marrë 2 propozime që në fillim dhe të kalonin në votim...U ezaurua...mos e ngatërroni me debat politik...

Z.Atird Hoxha – Zoti Moçka, përsa i përket votimit të qytetarëve, është mbyllur në 14 maj , ashtu edhe për opozitën është përcaktuar me votë. Sipas rregullores, 4 komisione i takojnë opozitës. U propozua, por su votua. Në momentin që thuhet dhe ngelen në procesverbal.....Opozitën e përcakton qytetari ashtu dhe mazhorancënPra, mazhoranca është bërë bashkë me një opozitë të vogël...Po thoni që po ja jepni opozitës, por në fakt një pjesë të vogël, pra jeni në dakordancë.

Z.Ervis Moçka – Nuk mund ta kthejmë në debat politik. E njohim opozitën për atë që njohim..e hedhim në votim.

Z.Klodian Xhyheri – Më keq akoma se në mbledhjen e parë, ku u zgjodh zëvendëskryetari i këshillit bashkiak. Edhe sot PS dhe PD, vula e dhuruar .., është 3 , jo opozitë dhe Bashkë fitojmë 9 anëtarë. Ju me këtë opozitë, 3 anëtarë të vulës së dhuruar , keni përcaktuar opozitën ...Ne mendojmë, i takojnë shumicës së opozitës...Është.., ka dalë hapur se PS dhe PD ,Vula e dhuruar përcaktojnë opozitën. Forcën e kartonit e keni dhënë në dakortësi të plotë.

Z.Myzafer Elezi – Do të jap një sqarim për të dy mbledhjet. Zoti Myzafer Elezi ka qenë anëtar i PD që 20 vjeç dhe do përfaqësojë interesat e qytetarëve. Në lidhje me procesin , ju mund ta atakoni, është e drejta juaj. Meqenëse, kërkoni shfuqizim të zv/kryetarit të këshillit bashkiak, referojuni nenit 56, pika 1, referojuni ligjit, është procedurë për shfuqizimin e zv/kryetarit. Një pjesë e kanë kaluar në personale. Të gjithë jemi të votuar, për të qenë këtu ku jemi. Vazhdoni në të drejtën tuaj, vazhdoni procesin gjyqësor.

Z.Evis Allushi – Nuk do të doja të ndalonim sot tek forca e përdorimit të kartonit. Është mbledhja e parë. Debate konstruktive do të ketë, ka shumë problematika dhe çështje më të rëndësishme për tu diskutuar, si problemi i turizmit, jemi qytet turistik.

Z.Myzafer Elezi – Kemi ankesë nga qytetarët, në lidhje me problemin e ujit të pijshëm banorët e lagjes “Partizani”, të merren masa urgjente.

Znj.Elpiniaqi Mërkuri – Komisioni i peticioneve; 7 anëtarë, lexon emrat.

Pro

Kundër – 0 vota

Abstenim – 0 vota

Miratohet.

Votohet për kryetar zoti Myzafer Elezi .

Kundër – 4 anëtarë.Miratohet.

(Bashkëlidhur lista e anëtarëve të komisioneve të mbledhjeve të këshillit bashkiak)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2023

Procesverbal
Nr 9/4, datë 21.07.2023

Znj.Elpinqi Mërkuri – Kalojmë në pikën e tretë të rendit të ditës, në propozimin dhe miratimin e sekretarit të këshillit bashkiak.

Është propozimi im, duke parë dhe begraundin e zotit Daut Zëraj, e propozoj për sekretar të këshillit. Proçedura, është votim i mbyllur.

Z.Klodian Xhyheri – Lexon..Neni 26, pika 3 ...ku propozohet më shumë se një kandidat .

Znj.Elpinqi Mërkuri – Unë kam vetëm një propozim, zotin Daut Zëraj. Nëqoftëse, keni propozim tjetër...Zbatojmë ligjin, votim i fshehtë .

Z.Ervis Moçka – Në bazë të ligjit, është votim i fshehtë.

Z.Atird Hoxha – Unë mendoj të bëhet votim i hapur.

Znj.Elpinqi Mërkuri - Ngrejmë komisionin e votimit, me 3 anëtarë.

1.Illir Aliaj – Kryetar

2.Endri Hyseni – Sekretar

3.Besmir Brahimi – Anëtar

Të bëhen gati fletët e votimit. Fillon proçesi i votimit.

Mbas mbarimit të proçesit të votimit, lexon procesverbalin.

-37, anëtarë morërn pjesë në votim.

-35 vota – Pro

-1 votë – Kundër

-1 votë - Abstenim

Miratohet.

Emërohet në detyrën e sekretarit të këshillit , zoti Daut Zëraj (Bashkëlidhur procesverballi i komisionit dhe fletët e votimit)

Znj.Elpinqi Mërkuri – Suksese!

Z.Daut Zëraj/Sekretar i këshillit bashkiak – Faleminderit që më besuat, faleminderit që më votuat. Do të bëj maksimumin që proçedurat vendimmarëse të këshillit dhe kryetarit të

bashkisë, të jenë të koordinuara si një organ ekzekutiv. Do të bëj më të mirën që komunikimi im me ju , të jetë shumë i mirë. Faleminderit.

Znj.Elpinqi Mërkuri – Faleminderit të gjithëve. Çdo debat është në të mirë të qytetit dhe qytetarëve. Mbledhjen e radhës do ta zhvillojmë shumë shpejt, pasi kemi projektvendime që nuk presin, janë urgjentë.

Faleminderit.